

Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 të Ligjit për Arsimin e Mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 229/20, 78/25 dhe 132/25), ministria e Arsimit dhe Shkencës ka miratuar

RREGULLORE

për mënyrën e raportimit dhe mbrojtjes së nxënësit–viktimë nga çdo formë e dhunës, abuzimit dhe neglizhencës

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet mënyra e veprimit në rastet e dhunës, abuzimit dhe neglizhencës ndaj nxënësve në shkollën e mesme, si dhe mekanizmat për raportimin në kohë dhe mbrojtjen e duhur të nxënësit të prekur.

Në përputhje me legjislacionin dhe praktikën profesionale, rregullorja përdor termet si “viktimë”, “kryes”, “dëshmitar”, “vëzhgues” dhe “person kontakti”.

Me qëllim shmangien e stigmatizimit dhe ruajtjes së qasjes të orientuar drejt mbështetjes, këto terme përdoren në kuptimin vijues:

- **“Viktimë e dhunës”** i referohet nxënësit që ka përjetuar ose ka qenë i ekspozuar ndaj një forme të dhunës. Në komunikimin e përditshëm rekomandohet përdorimi i shprehjeve si: “nxënës ndaj të cilit është bërë padrejtësi”, “nxënës që është lënduar” ose “nxënës që përballlet me një situatë të vështirë”.
- **“Kryerës”** është personi, zakonisht një tjetër nxënës, që shfaq sjellje të dhunshme ose të papërshtatshme. Në komunikim, sugjerohen terma si: “nxënës që ka lënduar një nxënës tjetër”, “nxënës me sjellje problematike”.
- **“Dëshmitarë” dhe “vëzhgues”** janë persona që kanë qenë të pranishëm në një incident dhune, pavarësisht nëse kanë reaguar apo jo. Termet e dëshirueshëm janë: “nxënës që kanë qenë të pranishëm” ose “nxënës që e kanë parë ngjarjen”.
- **“Personi kontaktues për raportimin e dhunës”** është personi i emëruar nga shkolla, i ngarkuar për pranimin dhe trajtimin e raportimeve. Në komunikimin e përditshëm mund të përdoret edhe shprehja “person i besueshëm”.

Të gjithë termat përdoren në formë gjinore neutrale dhe vlejné njësoj për të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh gjininë, përkatësinë etnike, gjuhën, fenë, statusin shoqëror ose karakteristika të tjera personale.

Në kontekstin e kësaj rregulloreje, përcaktohen dhe përkufizohen këto nocione kryesore:

- **Dhuna** paraqet çdo veprim ose mosveprim që shkakton dëm, vuajtje ose cenim të dinjitetit të nxënësit. Dallohen format e mëposhtme të dhunës:
 - Dhunë fizike: goditje, shtyrje, rrahje, kërcënime me sende etj.
 - Dhunë emocionale/psikike: tallje, fyerje, kërcënime, nënvlerësim, manipulim.
 - Dhunë sociale: përjashtim, injorim, përjashtim i organizuar, përhapje thashethemesh.

- Dhunë seksuale: prekje pa leje, komente me konotacion seksual, ekspozim, detyrim për akte seksuale.
- Dhunë kibernetike: mesazhe fyese, postime, ngacmime digjitale ose ekspozim i nxënësit përmes internetit.
- **Abuzimi** nënkupton shfrytëzimin e nxënësit për një qëllim apo në një mënyrë që është e dëmshme për shëndetin, sigurinë ose zhvillimin e tij – përfshirë abuzimin seksual, shfrytëzimin, manipulimin apo keqpërdorimin e pushtetit.
- **Neglizhenca** është mospërmblidhja e detyrimeve ndaj nxënësit nga ana e prindit, kujdestarit ose ndonjë personi tjetër, që çon në mungesë të kujdesit për nevojat e tij bazë – fizike, arsimore, shëndetësore ose emocionale.

Gjatë konstatimit dhe vlerësimit të dhunës, shkolla i kushton vëmendje të veçantë situatave në të cilat nxënësi mund të jetë i ekspozuar ndaj dhunës, diskriminimit ose përjashtimit mbi baza të karakteristikave personale, pamjes së jashtme, sjelljes, gjendjes familjare apo përkatësisë, për shkak të të cilave perceptohet si “ndryshe” nga mjedisi. Në raste të tilla, shkolla është e detyruar të veprojë me ndjeshmëri të shtuar, duke u udhëhequr nga parimet e barazisë, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

Neni 2

Me këtë rregullore rregullohen masat dhe aktivitetet që ndërmarrin shkollat e mesme në rastet e dhunës ndaj nxënësit dhe masat për ndryshimin e sjelljes së kyesit.

Me këtë rregullore rregullohen gjithashtu masat dhe aktivitetet për parandalimin e dhunës dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera në hartimin dhe zbatimin e këtyre masave.

Neni 3

Çdo i punësuar në shkollë, përfshirë edhe personelin administrativ dhe ndihmës-teknik, si dhe personat e angazhuar për sigurimin e shkollës, është i detyruar të raportojë dhunën ose dyshimin për dhunë ndaj një nxënësi, pa marrë parasysh nëse dhuna ka ndodhur në shkollë, në rrugën për në shkollë, në oborrin e shkollës, në shtëpinë e nxënësit apo në ndonjë vend tjetër.

Të gjithë të punësuarit, pa përjashtim, kanë për detyrë të jenë të vëmendshëm ndaj shenjave të mundshme të dhunës dhe të veprojnë në përputhje me rolin e tyre brenda shkollës. Mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe drejtori kanë për detyrë të njohin dhunën, të ndjekin rregullisht nëse ndodhin raste dhune në shkollë, nëse ndonjë nxënës është viktimë apo kryes i dhunës dhe të reagojnë me kohë.

Nëse vërejnë dhunë, mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe drejtori janë të detyruar të zbatojnë menjëherë këtë rregullore, në përputhje me procedurën e përcaktuar.

Nëse ndonjë nga të punësuarit, përfshirë personelin administrativ, teknik apo sigurimin, dyshon se ekziston dhunë, ai/ajo është i/e detyruar të ndajë menjëherë informacionin me personin kontaktues, përkatësisht me bashkëpunëtorët profesionalë dhe me udhëheqësin e klasës, udhëheqësin e paraleles ose ndonjë mësimdhënës tjetër që është në komunikim të drejtpërdrejtë me nxënësin. Më tej, vazhdohet me vëzhgimin e situatës dhe/ose ndërmarrjen e masave të përshtatshme për mbrojtjen e nxënësit në përputhje me rregulloren.

Neni 4

Drejtori i shkollës është i detyruar të caktojë një person kontaktues për raportimin e dhunës dhe zëvendësin e tij nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë (psikolog, pedagog, punonjës social, edukator dhe rehabilitues special apo sociolog), për të cilët vlerëson se kanë komunikimin më të mirë me nxënësit, aftësitë dhe vlerat më të përshtatshme për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna, dhe që gëzojnë besimin e nxënësve. Zëvendësi mund të caktohet edhe nga radhët e mësimdhënësve.

Shkolla është e detyruar të sigurojë çdo lloj forme komunikimi ndërmjet nxënësve dhe personit kontaktues dhe zëvendësit të tij për raportimin e dhunës: telefon, paraqitje me shkrim, paraqitje përmes postës elektronike apo ndonjë aplikacion tjetër që përdoret zakonisht nga nxënësit. Shkolla është e detyruar të sigurojë një numër telefoni zyrtar dhe një adresë elektronike për personin kontaktues dhe zëvendësin e tij, të cilat përdoren ekskluzivisht për raportimin e dhunës dhe për komunikimin lidhur me rastet e dhunës.

Emri dhe informacionet e kontaktit të personave nga paragrafi 1 i këtij neni publikohen në aktin e brendshëm të shkollës sipas nenit 5 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, në vende të dukshme brenda shkollës dhe në faqen zyrtare të internetit të shkollës.

Neni 5

Çdo shkollë është e detyruar që më së voni deri më 1 shtator të miratojë një akt të brendshëm me të cilin rregullohet në mënyrë të detajuar mënyra e sjelljes në shkollë, masat për mbrojtje dhe parandalim nga dhuna, si dhe përgjegjësitë e të punësuarve, nxënësve, prindërve/kujdestarëve dhe të gjithë faktorëve të tjerë në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna.

Në përbërje të kësaj rregulloreje, si **Shtojca 1**, është dhënë një tabelë me role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për të gjitha kategoritë e të punësuarve dhe palëve të përfshira në shkollë, përfshirë edhe personelin administrativ dhe ndihmës-teknik, si dhe personat e ngarkuar me sigurimin. Kjo tabelë duhet të përditësohet në përputhje me ndryshimet organizative dhe të stafit. Shkolla është e detyruar të caktojë një person nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë, i ngarkuar për zbatimin e aktit të brendshëm nga paragrafi 1 i këtij neni, dhe emri i tij/saj së bashku me informacionet e kontaktit duhet të përfshihen në përmbajtjen e dispozitave. Ky person mund të jetë i njëjti me pikën e kontaktit për raportimin e dhunës.

Udhëheqësi i klasës/paraleles është i detyruar ta prezantojë aktin e brendshëm dhe këtë rregullore gjatë orës së bashkësisë klasore, menjëherë pas fillimit të vitit shkollor, në mënyrë të përshtatur me moshën e nxënësve.

Shkolla është e obliguar që aktin e brendshëm, së bashku me këtë rregullore, ta publikojë në faqen e saj të internetit.

Neni 6

Shkolla është e detyruar të sigurojë mundësinë e raportimit anonim të dhunës, përmes:

1. **Kutisë për raportime**, e vendosur në një vend të dukshëm dhe të qasshëm në shkollë, me shenjëzimin përkatës dhe njoftimin e nxënësve se mund ta përdorin për të paraqitur dhunë në mënyrë anonime;
2. **Formularit online**, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të shkollës, me mundësi për paraqitje anonime të dhunës..

Personi kontaktues për raportimin e dhunës është i detyruar:

- të hapë kutinë së paku një herë në javë, ose menjëherë pas marrjes së informatës se mund të ketë raportim në të;
- së bashku me zëvendësin e tij/saj, të ketë qasje të rregullt në raportimet online dhe t'i kontrollojë ato të paktën një herë në javë;
- të mbajë evidencë për datën e pranimit të raportimit dhe për hapat e ndërmarrë, pa e cenuar anonimitetin e raportuesit.

Raportimi i dhunës mund të dorëzohet te çfarëdo punonjësi i shkollës. Personi kontaktues nuk është mënyra e vetme për aktivizimin e procedurës. Punonjësi që ka marrë informacion për dhunë (drejtpërdrejt ose përmes raportimit) është i detyruar ta njoftojë menjëherë personin kontaktues për raportimin e dhunës.

Personi kontaktues, së bashku me punonjësin që e ka pranuar raportimin, e vlerësojnë situatën dhe bashkë vendosin për masat e duhura për mbrojtje, në përputhje me këtë rregullore.

Neni 7

Pas raportimit së një rasti dhune ose dyshimi për dhunë ndaj një nxënësi, shkolla është e detyruar të nisë menjëherë procedurën për konstatimin e fakteve dhe të përfshijë të gjitha palët e interesuara:

- nxënësin – viktimë,
- nxënësin – kryes,
- nxënësit – dëshmitarë,
- nxënës ose punonjës të tjerë të përfshirë,
- prindërit/kujdestarët e nxënësve të përfshirë.

Përgjegjësinë për zhvillimin e procedurës e ka personi kontaktues për raportimin e dhunës, në bashkëpunim me shërbimin profesional (psikolog, pedagog, punonjës social, sociolog, edukator dhe rehabilitues special) dhe drejtorin. Ky ekip koordinon komunikimin me të gjitha palët e përfshira, mban evidencë të procesit dhe ndërmerri masa të mëtejshme.

Pas një vlerësimi paraprak se ekziston nevoja, shkolla mund të përfshijë edhe përfaqësues të institucioneve të jashtme, si:

- Qendrën për Punë Sociale,
- Institucionin shëndetësor,
- Ministrinë e Punëve të Brendshme,
- Prokurorinë Publike,
- Vetëqeverisjen Lokale,
- Organizata joqeveritare apo ekspertë me njohuri në fushën e dhunës ndaj fëmijëve,

- Shërbime të tjera për mbrojtje sociale dhe të fëmijëve.

Vlerësimin e kryen personi kontaktues në bashkëpunim me shërbimin profesional, ndërsa përfshirja e subjekteve të jashtme miratohet nga drejtori.

Në rastet kur shkolla vlerëson se përfshirja e prindërve/kujdestarëve apo ndonjë pale tjetër mund ta rrezikojë interesin më të mirë të fëmijës – të çojë në viktimizim, rrezik të drejtpërdrejtë ose rritje të rrezikut për dhunë të re – atëherë prindërit/kujdestarët apo pala tjetër nuk do të përfshihen. Për një vendim të tillë, shkolla është e detyruar ta njoftojë menjëherë Qendrën për Punë Sociale, dhe masat e mëtejshme do të ndërmerren në koordinim me shërbimet për mbrojtje sociale dhe të fëmijëve.

Të gjitha procedurat, komunikimet dhe masat e ndërmarra dokumentohen me shkrim (procesverbale, shënime zyrtare, formularë...) dhe ruhen në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Neni 8

Shkolla respekton privatësinë e nxënësit gjatë raportimit dhe mbrojtjes së një nxënësi–viktimë nga çfarëdo formë e dhunës, abuzimit apo neglizhencës.

Shkolla është e detyruar të sigurojë që bisedat me nxënësit të zhvillohen në hapësira të përshtatshme që garantojnë diskrecion dhe privatësi, gjatë ndërmarrjes së masave për mbrojtjen e nxënësit–viktimë dhe masave për ndryshimin e sjelljes së nxënësve–kryes.

Për më tepër, shkolla është e detyruar të ndërmarrë masa për mbrojtjen e identitetit dhe dinjitetit të nxënësit – pavarësisht nëse bëhet fjalë për nxënës–viktimë apo nxënës–kryes – gjatë komunikimit me mediat dhe opinionin publik.

Nuk lejohet shpërndarja e të dhënave personale, fotografive, incizimeve apo detajeve që mund të çojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në identifikimin e nxënësit.

Shkolla duhet të informojë në mënyrë proaktive të punësuarit, prindërit/kujdestarët dhe partnerët për rëndësinë e diskrecionit dhe t'i udhëzojë mediat që të përmbahen nga raportime që mund të shkaktojnë dëm shtesë ndaj nxënësve të përfshirë.

Neni 9

Të gjitha informacionet që lidhen me rastin e dhunës, viktimën dhe kryesin, si dhe informacionet për palët e tjera të përfshira në rastin e dhunës, janë konfidenciale.

Çdo i punësuar në shkollë, apo profesionist tjetër që posedon çfarëdo informacioni për rastin e dhunës, ka për detyrë t'i ruajë ato dhe nuk guxon t'i ndajë me persona që nuk janë të përfshirë në ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes.

Shkolla është e obliguar t'ia shpjegojë nxënësit–viktimë, në mënyrë të kuptueshme dhe të përshtatur me moshën, pjekurinë dhe kapacitetet e tij/saj, çfarë nënkupton konfidencialiteti dhe cilët janë personat e tjerë me të cilët do të ndahet informacioni, si dhe roli dhe përgjegjësitë e tyre në procedurat, masat dhe aktivitetet e mëtejshme.

Punonjësi të cilit nxënësi–viktimë i është besuar për rastin e dhunës, nuk guxon t'i ndajë informacionet, përveç nëse vlerëson se informacionet duhet ose është i detyruar t'i ndajë me persona të tjerë të autorizuar për të siguruar mbrojtjen dhe mbështetjen e nxënësit.

Neni 10

Në procedurën për mbrojtjen e një nxënësi–viktimë të dhunës, shkolla ndërmerr masa të përshtatshme sigurie me qëllim që nxënësi të mos krijojë përshtypjen se përmes raportimit së dhunës po shkakton probleme në shkollë.

Gjatë ofrimit të mbrojtjes dhe mbështetjes për nxënësin–viktimë të dhunës, shkolla respekton dhe u jep legjitimitet përjetimeve personale të viktimës, pa u thirrur në fakte që mund të duken si të vetëkuptueshme.

Aktivitetet dhe masat për mbrojtjen e nxënësit–viktimë nuk guxojnë të rezultojnë në viktimizim, përjashtim apo izolim, rrezik të drejtpërdrejtë apo rritje të rrezikut nga çfarëdo lloj dhune ndaj viktimës.

Nëse kryesi është nxënësi, shkolla do të marrë vendime lidhur me masat dhe aktivitetet ndaj tij, të bazuara në mirëkuptim dhe njohje të kushteve, karakteristikave dhe kontekstit në të cilin jeton nxënësi–kryes.

Nëse ekziston dyshim se nxënësi është i ekspozuar ndaj abuzimit apo neglizhencës nga ana e prindit, kujdestarit apo ndonjë personi tjetër, shkolla vepron me kujdes të shtuar dhe konfidencialitet të plotë, duke aktivizuar të njëjtat parime të mbrojtjes si në rastet e dhunës. Në këto situata, shkolla bashkëpunon me institucionet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Shkolla është e detyruar të ndërmarrë masa për mbrojtje dhe mbështetje për çdo fëmijë, veçanërisht në rastet e dhunës të ushtruar mbi baza të karakteristikave personale, dallimeve apo përkatësisë, të cilat mund ta ekspozojnë nxënësin ndaj rrezikut të shtuar për diskriminim, përjashtim apo stigmatizim.

Këto masa kanë rëndësi të veçantë për nxënësit që mund të përballen me dhunë për shkak të pamjes së tyre, mënyrës së të shprehurit, bindjeve, rrethanave familjare apo ndonjë arsye tjetër për shkak të së cilës perceptohen si “të ndryshëm” nga të tjerët.

Gjatë vlerësimit të rreziqeve dhe përcaktimit të masave për mbrojtje, shkolla është e detyruar të marrë parasysh kontekstin e dhunës, motivet e mundshme dhe nevojat specifike të nxënësit, duke u udhëhequr nga parimet e respektimit të dallimeve, barazisë dhe përfshirjes.

Neni 12

Shkolla ndërmerr masa dhe aktivitete proporcionale në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna.

Proporcionaliteti nënkupton që masat e mbrojtjes dhe mbështetjes ndaj nxënësit–viktimë të dhunës do të jenë të qëllishme dhe në përputhje me pasojat e dhunës.

Proporcionaliteti nënkupton që masat që ndërmerren ndaj nxënësit–kryes do të jenë të qëllishme dhe të përpjestuara me seriozitetin e dhunës dhe pasojat që ka pësuar viktimja.

Masat ndaj nxënësit–kryes kanë për qëllim parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe risocializimin përmes mbështetjes psiko-sociale, edukimit dhe ndikimit mbi faktorët që kanë kontribuar në sjelljen e dhunshme. Masat pedagogjike zbatohen vetëm në përputhje me Ligjin për arsimin e mesëm dhe vetëm në rastet kur masat dhe aktivitetet e tjera nuk kanë dhënë rezultate.

Neni 13

Gjatë zbatimit të masave dhe aktiviteteve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna, asnjë i punësuar në shkollë nuk guxon të veprojë dhe/ose të përmbahet nga veprimi nën ndikimin e përfitimit të ndonjë dobie të çfarëdo lloji apo të ndonjë premtimi për përfitim.

Nëse një i punësuar në shkollë, i cili merr vendime dhe zbaton masa dhe aktivitete për mbrojtje nga dhuna, gjendet në konflikt interesi, është i detyruar ta deklarojë këtë dhe të tërhiqet nga ekipi. Me konflikt interesi nënkuptohet gjendja në të cilën personi i punësuar ka një interes privat që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen e paanshme të detyrave të tij për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna.

Gjatë zbatimit të masave dhe aktiviteteve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna, respektohen dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, dhe çdo i punësuar në shkollë është i detyruar të raportojë çdo njohuri për shkelje të këtij ligji.

Neni 14

Në rastet e dhunës ndaj nxënësve, punonjësit e shkollës janë të detyruar ta ndalin menjëherë dhunën. Ndërprerja e dhunës është detyrë e çdo punonjësi që ka marrë informacion për rastin ose ka qenë dëshmitar i dhunës.

Nëse bëhet fjalë për një formë më serioze të dhunës (p.sh., përleshje ku marrin pjesë një numër i madh nxënësish, dhunë fizike ku nxënësit përdorin thikë ose armë tjetër), dhe punonjësit vlerësojnë se nuk mund ta ndalojnë vetë, ata menjëherë do të thërrasin policinë.

Nëse autori i dhunës është i rritur, pavarësisht nëse është punonjës tjetër i shkollës, një person i tretë ose prind/kujdestar, drejtori ka detyrë të thërrasë policinë dhe/ose qendrën për punë sociale. Nëse autori është punonjës i shkollës, drejtori është i detyruar të veprojë në përputhje me Ligjin për arsimin e mesëm dhe Ligjin për mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme.

Në rastet kur punonjësit dyshojnë se një nxënës është viktimë e ndonjë lloji dhune, pavarësisht vendit ku ka ndodhur dhe kush është autori potencial, punonjësit janë të detyruar ta informojnë personi kontaktues për raportimin e dhunës. Pas kësaj, personi kontaktues zhvillon bisedë me nxënësin dhe/ose me persona të tjerë që mund të kenë njohuri.

Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë zhvillojnë gjithashtu bisedë me prindërit/kujdestarët, përveç në rastet kur një bisedë e tillë nuk është në interesin më të mirë të fëmijës – për shembull, kur ekziston dyshim se prindi/kujdestari është vetë kryesi ose përgjegjës në ndonjë mënyrë për dhunën, ose kur përfshirja e prindit/kujdestarit mund të shkaktojë dhunë ndaj nxënësit. Në këto raste, thirret Qendra për Punë Sociale.

Në rast se dhuna ka ndodhur në shtëpinë e nxënësit ose në ndonjë vend tjetër, dhe punonjësit kanë marrë informacion përmes shenjave të dukshme në trupin e nxënësit apo përmes sjelljes së tij, punonjësi që i ka vërejtur këto shenja e njofton personin kontaktues për raportimin e dhunës, i cili në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë dhe mësimdhënësit të tjerë relevantë mund të zhvillojnë bisedë me nxënësin ose me persona të tjerë për të marrë informacione më të sakta. Këto raste shkolla është e detyruar t'i raportojë në Qendrën për Punë Sociale.

Neni 15

Kur bëhet fjalë për një incident dhune pa pasoja të rëndësishme, që ndodh për herë të parë sipas atyre të listuara në **Tabela nr. 1**, e cila jepet në **Shtojcën nr. 1** dhe është pjesë përbërëse e këtij rregullore, punonjësi që ka ndaluar dhunën **nuk është i detyruar** të thërrasë personin kontaktues për raportimin e dhunës, por duhet vetë të qetësojë situatën. Në rast se vlerëson se nuk mund të ndikojë vetë ose situata fillon të eskalojë përsëri, ai do të thërrasë personin kontaktues.

Kur bëhet fjalë për një incident dhune nga **Tabela nr. 1** që përsëritet, ose për dhunë nga **Tabela nr. 2** dhe **Tabela nr. 3**, të cilat janë të dhëna në **Shtojcën nr. 1** dhe janë pjesë përbërëse e këtij rregullore, punonjësi është i detyruar të thërrasë personin kontaktues për raportimin e dhunës.

Personi kontakti për raportimin e dhunës vlerëson, në varësi të rrethanave të rastit, nëse do të thërrasë dhe përfshijë punonjës të tjerë të shkollës, si mësues të caktuar, bashkëpunëtorë profesionalë dhe/ose drejtorin. Personin kontaktues mund të vendosë në këtë fazë të thërrasë edhe përfaqësues nga institucione të tjera, si përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qendrës për Punë Sociale, institucionit shëndetësor ose ndonjë person tjetër që sipas ekspertizës dhe pozitës zyrtare mund të ndihmojë në qetësimin e situatës.

Kur bëhet fjalë për raste dhune nga **Tabela nr. 3**, është e detyrueshme të thërrasen përfaqësues të institucioneve të tjera (Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra për Punë Sociale, institucioni shëndetësor dhe të tjera që do të vlerësojë personin kontaktues ose drejtorin). Sa herë që thërrasin institucione të tjera, personin kontaktues informon drejtorin, përveç në rastet kur për shkak të urgjencës duhet menjëherë të thirret policia.

Kur përfshihen përfaqësues të institucioneve të tjera, për shumicën e rasteve rekomandohet personin kontaktues dhe punonjësit e shkollës të kryejnë bisedat me nxënësit, në vend të përfaqësuesve të institucioneve të tjera, të cilët janë të panjohur për nxënësit dhe mund të shkaktojnë frikë ose shqetësim, veçanërisht në rastin e një polici të uniformuar. Megjithatë, nëse bëhet fjalë për dhunë nga **Tabela nr. 3**, sidomos dhunë që përbën vepër penale, fillimisht veprojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qendrës për Punë Sociale dhe institucionit shëndetësor, dhe më pas punonjësit bisedojnë me nxënësit dhe ndërmarrin masa shtesë mbrojtëse. Bisedat mund të bëhen edhe ditën pasuese ose në momentin e parë kur krijohen kushtet.

Përfshirja e përfaqësuesve nga institucionet e tjera dhe ndërmarrja e masave në çdo fazë nga institucionet nuk nënkupton në asnjë rast që shkolla ndalon të ndërmarrë masa dhe aktivitete për qetësimin e situatës, parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe mbrojtjen e viktimës. Në këto raste, personin kontaktues për raportimin e dhunës bashkëpunon intensivisht me përfaqësuesit e institucioneve të tjera, koordinon masat, i harmonizon ato dhe shkëmben informacion mbi efektivitetin e masave, nevojën për ndryshime, intensifikim ose ndërprerje. Nëse lind situata kur shkolla vlerëson se masat e institucioneve të tjera nuk janë të përshtatshme, nuk janë në interesin më të mirë të fëmijës, ose përfaqësuesit e institucioneve të tjera refuzojnë bashkëpunimin, nuk vijnë ose nuk ndërmarrin masa, shkolla është e detyruar të informojë ministrinë kompetente, personat e lartë në ministri ose inspektoratet përkatëse. Nëse përsëri nuk ka asnjë veprim nga institucionet, informohet Avokati i Popullit.

Në këtë fazë, qëllimi kryesor është të merren informacione për shkaqet dhe faktorët që çuan në dhunë, të përcaktohet sa më saktë kush ka qenë i përfshirë, sa ka zgjatur, nëse ka pasur përsëritje, cilat janë karakteristikat personale të viktimës dhe kryesit, dëshirat dhe nevojat e viktimës, të vlerësohet efekti dhe pasojat mbi shëndetin psikofizik dhe zhvillimin e nxënësit-viktimë, marrëdhëniet me prindërit/kujdestarët dhe nëse është e nevojshme dhe e përshtatshme t'i përfshihen në vendimmarrjen për masat ndaj nxënësit-viktimë dhe kryesit.

Këto masa përfshijnë biseda me të gjithë nxënësit e përfshirë në dhunë: nxënësin–viktimë, nxënësin–kryes dhe nxënësit dëshmitarë. Bisedat me viktimën dhe kryesin duhet të bëhen veçmas, në dhoma të veçanta dhe pa praninë e nxënësve të tjerë. Biseda private rekomandohet edhe me dëshmitarët, sepse për shkak të dinamikës së grupit, frikës nga përjashtimi ose gjykimi, ata mund të hezitojnë të japin informacion të saktë. Bisedat kryhen nga personin kontaktues ose një punonjës tjetër të cilit viktimë i ka dhënë besim, ose nxënësi ka kërkuar vetë të bisedojë me këtë person. Personin kontaktues mund të vendosë të përfshijë edhe punonjës të tjerë, mësues ose bashkëpunëtorë profesionalë në biseda, në përputhje me kushtet e ngjarjes. Megjithatë, duhet pasur parasysh se bisedat shpesh janë më efektive nëse marrin pjesë sa më pak persona, kryhen privat dhe garantojnë konfidencialitetin. Nxënësit, veçanërisht viktimë, nuk duhet të kërkohet të tregojnë ngjarjen disa herë, përpara personave të ndryshëm, ose të përgjigjen disa herë në të njëjtat pyetje si shenjë mosbesimi ndaj përgjigjeve të dhëna ose për të "kapur në gënjeshtëri".

Kur bëhet fjalë për raste dhune nga **Tabela nr. 1** që përsëriten, ose raste dhune nga **Tabela nr. 2** dhe **Tabela nr. 3**, personi kontakti ose punonjësi tjetër që ka biseduar me nxënësit, në mënyrë të saktë dhe pa tepruar, do të shënojë deklaratat e të gjithë nxënësve menjëherë pas përfundimit të bisedave.

Neni 16

Pas marrjes së informacionit nga bisedat me të gjitha palët e përfshira dhe dëshmitarët e dhunës, drejtori i shkollës, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë, është përgjegjës për vendosjen e masave që do të ndërmerren për mbrojtje.

Në rastet e parashtruara në Tabelën nr. 1 të Shtojcës 2 të Rregullores – përkatësisht, kur bëhet fjalë për incidente të njëhershme dhe me intensitet më të ulët – mësimdhënësi, bashkëpunëtori profesional ose drejtori që e ka ndërprerë aktin e dhunës mund të vendosë në mënyrë të pavarur për masat e brendshme që do të ndërmerren, brenda kompetencave të veta. Këto masa mund të përfshijnë:

- ndarje fizike të kryesit të dhunës nga viktimë (ndryshim i vendit të uljes, i hapësirës),
- bisedë individuale me viktimën për vlerësimin e nevojës për mbështetje psiko-sociale,
- bisedë individuale me dhunuesin dhe sqarim mbi pasojat e sjelljes së tij,
- bisedë me klasën ose grupin e nxënësve për të sqaruar papërshtatshmërinë e sjelljes së dhunshme,
- referim të kryesit të dhunës apo viktimës për këshillim të bashkëpunëtorët profesionalë,
- nxitje e nxënësve për komunikim të padhunshëm dhe ndërmjetësim të konflikteve.

Në rastet e **Tabelës nr. 1** që përsëriten dhe në të gjitha rastet e **Tabelës nr. 2**, shkolla është e detyruar të hartojë një **plan të shkruar për mbrojtjen e viktimës dhe plan për ndryshimin e sjelljes së kryesit**. Personi kontaktues për raportimin e dhunës është përgjegjës për hartimin e planit dhe mund të vendosë të përfshijë edhe persona të tjerë (mësues, bashkëpunëtorë profesionalë, drejtor, përfaqësues nga institucione, ekspertë, shoqata etj.).

Në rastet nga Tabela nr. 3 e Shtojcës 2 të kësaj rregulloreje, shkolla është e detyruar të përgatisë plan të shkruar, në të cilin:

- përfshihet përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale,
- përfshihet përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme (nëse bëhet fjalë për vepër penale),
- përfshihen përfaqësues nga institucione shëndetësore (nëse ka pasoja serioze mbi shëndetin fizik ose mendor të nxënësit).

Personi kontaktues është përgjegjës për koordinimin e hartimit të planit, mbajtjen e procesverbaleve dhe dokumentimin e aktiviteteve të ndërmarra, në bashkëpunim me të gjitha palët e përfshira. Drejtori është përgjegjës për verifikimin e planit, ndjekjen e zbatimit të tij dhe ndërmarrjen e masave shtesë nëse është e nevojshme.

Plani për mbrojtje përgatitet edhe në situata kur ekziston dyshim ose është konstatuar ekzistenca e abuzimit apo neglizhimit të nxënësit, me ç'rast shkolla është e detyruar të veprojë me kujdes të shtuar dhe në bashkëpunim me institucionet kompetente. Në raste të tilla, plani përmban masa për sigurimin e një ambienti të sigurt për nxënësin, mbështetje psiko-sociale, si dhe eventualisht përfshirjen e Qendrës për Punë Sociale apo shërbimeve të tjera profesionale, në përputhje me natyrën e rastit.

Neni 17

Plani për mbrojtjen e nxënësit–viktimë dhe ndryshimin e sjelljes së kryesit, i parashikuar në nenin 16 (paragrafët 3, 5 dhe 7), mund të përfshijë disa lloje masash, zbatim i të cilave është në kompetencë të subjekteve të ndryshme brenda shkollës, si vijon:

1. Mbështetje psiko-sociale për viktimën:

- E zbatojnë psikologu i shkollës dhe/ose bashkëpunëtori profesional,
- Zgjat deri në arritjen e rezultateve dhe sipas vlerësimit të personelit profesional,
- Nëse viktimë merr mbështetje jashtë shkollës, psikologu i shkollës koordinon me specialistin e jashtëm,
- Nëse shkolla nuk ka kapacitete, personi kontakti për raportimin e dhunës ndërmjetëson me institucionet shëndetësore ose këshillimorët.

2. Masa për ndarje fizike të viktimës nga kryesi:

- Vendosja e masave bëhet nga drejtori pas propozimit të personit kontakti dhe ekipit profesional,
- Mund të përfshijë: zhvendosje të autorit, ndalim afërsie, kufizim të aktiviteteve të përbashkëta,
- Për rastet e **Tabelës nr. 3**, këto masa janë të detyrueshme.

3. Masa për ndarje fizike të viktimës:

- Aplikohen vetëm sipas kërkesës së viktimës dhe vlerësimit të stafit profesional se është në interesin e saj më të mirë,
- Përfshijnë: përjashtim nga mësimi, mësim nga shtëpia, zhvendosje në klasë tjetër,
- Përgjegjës për vlerësimin dhe zbatimin është shërbimi profesional në koordinim me drejtorin.

4. Masat për ndryshimin e sjelljes së kryesit (nëse është nxënësi):

- Zbatohet nga psikologu i shkollës ose bashkëpunëtori profesional,
- Personi kontaktues është përgjegjës për monitorimin e përparimit,
- Mund të përfshihen edhe prindërit/kujdestarët dhe të udhëzohen për këshillim,
- Mbështetet në evidencë të shkruar të aktiviteteve,

- Pas vlerësimit të ekipit profesional dhe me miratimin e drejtorit, mund të propozohet edhe masa organizative e përkohshme për mbrojtjen e viktimës dhe parandalimin e sjelljes së përsëritur.

Këto masa mund të përfshijnë:

- Zhvendosje në klasë tjetër,
- Mësim nga shtëpia (në raste të jashtëzakonshme dhe me pëlqimin e prindërve),
- Kufizim i përfshirjes në aktivitete jashtëshkollore ose ngjarje shkollore.

Masat zbatohet vetëm në interesin më të mirë të nxënësve dhe nuk duhet të kenë karakter dënues, por të sigurojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetje për zhvillimin e sjelljes shoqërisht të pranueshme.

5. Masat pedagogjike sipas nenit 58 të Ligjit për Arsimin e Mesëm:

- Vendosen pas rekomandimit të kuadrit profesional dhe vendimit të drejtorit, vetëm nëse masat e mëparshme nuk kanë dhënë rezultat dhe në rastet e **Tabelës nr. 2** ose **Tabelës nr. 3**.

6. Zhvendosja e kryesit në shkollë tjetër nuk është masë pedagogjike, por masë mbrojtëse për viktimën:

- Vendoset nga drejtori nëpërmjet këshillit të mësuesve dhe zbatohet në bashkëpunim me pushtetin lokal,
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës informohet për vendimin,
- Personi kontaktues koordinon me shkollën e re dhe siguron transferimin e informacionit të nevojshëm.

7. Masat për mbështetje të dëshmitarëve dhe vëzhguesve:

- Biseda individuale ose në grup me nxënësit, udhëhiqet nga personi kontaktues, bashkëpunëtori profesional ose mësuesi,
- Për rastet e **Tabelës nr. 2 (përsëritëse)** ose **Tabelës nr. 3**, ofrohet mbështetje psiko-sociale ose referohet në institucion kompetent,
- Mund të përfshijë aktivitete edukative (workshop-e për komunikim pa dhunë, mbështetje nga bashkëmoshatarët, leksione etj.),
- Organizimi dhe zbatimi është përgjegjësi e stafit profesional.

Të gjitha masat e parashikuara në plan dokumentohen në formë të shkruar, me përgjegjës të qartë për zbatimin, afate dhe rezultatet e pritura. Për zbatimin e planit përgjegjës është personi kontaktues për raportimin e dhunës, i cili koordinon, monitoron dhe raporton përparimin tek drejtori dhe ekipi profesional.

Neni 18

Masat nga neni 17 i kësaj rregulloreje, të cilat kanë të bëjnë me nxënësin-viktimë të dhunës, duhet të merren me përfshirjen e saj, me pëlqimin e saj dhe duke marrë parasysh dëshirat dhe nevojat e saj. Të gjitha propozimet, personi kontakt apo një person tjetër i besuar nga viktimja, ia shpjegon asaj në mënyrë të detajuar dhe të kuptueshme, të përshtatur me moshën, dhe përpiqet ta aftësojë për të marrë një vendim të informuar. Me viktimën punohet me durim, i jepet kohë për të vendosur, për ta ndryshuar mendimin, për të refuzuar ndonjë propozim dhe për të pasur mundësinë që të ndalë procesin edhe nëse ai tashmë ka filluar të zbatohet.

Personi kontaktues ose ndonjë punonjës tjetër i besuar nga nxënësi dhunues do të bisedojë me të për masat e marra, rezultatit që synohet të arrihet, hapat e ardhshëm që do të ndërmerren dhe pasojat me të cilat do të përballlet. Nxënësi dhunues nuk duhet të akuzohet dhe gjykohet, por duhet të ndikohet në mënyrë konstruktive në ndryshimin e sjelljes së tij dhe të faktorëve që kanë çuar në

sjelljen e dhunshme.

Prindërit/kujdestarët e viktimës dhe të kryesit të dhunës përfshihen në hartimin e planit për mbrojtjen e nxënësit viktimë dhe për ndryshimin e sjelljes së kryesit të dhunës, çdoherë kur kjo nuk është në kundërshtim me parimin e interesit më të mirë të fëmijës. Nëse prindërit/kujdestarët nuk bashkëpunojnë dhe veprojnë në dëm të fëmijës, shkolla ka për obligim të njoftojë Qendrën për Punë Sociale.

Nëse prindërit/kujdestarët sillen në mënyrë të dhunshme ose shkolla vlerëson se mund të ndodhë dhunë ose dëm ndaj ndonjë punonjësi të shkollës, ndaj nxënësve të tjerë apo ndaj prindërve/kujdestarëve të ndonjë nxënësi tjetër, përveç Qendrës për Punë Sociale, do të thirret edhe policia.

Neni 19

Plani për mbrojtjen e viktimës dhe për ndryshimin e sjelljes së kryesit të dhunës vlerësohet dhe plotësohet vazhdimisht, vlerësohet nëse jep rezultate, shqyrtohet gjendja e nxënësit viktimë dhe e nxënësit dhunues dhe mbi atë bazë përcaktohet kohëzgjatja dhe lloji i masave. Masat vazhdojnë derisa të arrihen rezultatet e dëshiruara, ndërsa pas kësaj i kushtohet vëmendje aktive sjelljes dhe zhvillimit të nxënësit viktimë dhe të nxënësit dhunues.

Neni 20

Plani për mbrojtjen e viktimës dhe ndryshimin e sjelljes së autorit nga **neni 16**, paragrafët 3, 5 dhe 7, në të gjitha versionet dhe shtesat e tij, ruhet së bashku me **Formularin e Evidencës**, i cili jepet në **Shtojcën 2** dhe është pjesë përbërëse e këtij rregullore.

Për hartimin e planit mund të përdoret formulari i dhënë në **Shtojcën 2**. Ky formular plotësohet menjëherë pas plotësimit të formularit të evidencës nga paragrafi 1 i këtij neni.

Personi kontaktues ose zëvendësi i tij, së bashku me të tjerët që janë të përfshirë në vendimmarrje dhe zbatim të masave për mbrojtjen e viktimës dhe ndryshimin e sjelljes së kryes të dhunës, plotësojnë pjesën për **vlerësimin e efektivitetit të masave**, në momentin që konstatojnë rezultatet e para, por jo më vonë se një muaj pas njoftimit për rastin e dhunës. Formulari mund të plotësohet sa herë ka nevojë, përderisa masat për mbrojtjen e viktimës dhe ndryshimin e sjelljes së autorit vazhdojnë. Plotësohen vetëm ato pjesë që ndryshojnë ose shtohen. Pas vlerësimit që masat kanë arritur efektin e tyre, përfundimisht plotësohet vetëm pjesa për **vlerësimin e efektivitetit të masave**.

Plani për mbrojtjen e viktimës dhe ndryshimin e sjelljes së autorit përfshin elementët e mëposhtëm:

- përshkrim i masave sipas **nënit 17**;
- rezultate dhe indikatorë të masave që monitorohen;
- afatet kohore të zbatimit;
- afatet kohore për vlerësim;
- informacion për personat e përfshirë në hartimin e planit;
- shënime (pjesë për pyetje të hapura, opinionet e ndryshme të personave të përfshirë, etj.);
- nënshkrim i personit kontakti dhe i drejtorit të shkollës;
- data e miratimit të planit.

Neni 21

Dosjet, planet dhe formularët për nxënësin–viktimë dhe nxënësin kryes të dhunës ruhen në shkollë për **katër vjet** pas përfundimit të arsimit të mesëm.

Në raportin e **Programit Vjetor të punës së shkollës** përfshihen të dhëna statistikore për çdo formë të dhunës, abuzimit dhe neglizhencës, si dhe të dhëna statistikore për mënyrën e veprimit të shkollës.

Neni 22

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, **nuk vlen** Udhëzimi për procedurën e raportimit dhe mbrojtjes së nxënësit–viktimë të dhunës, në çdo formë dhune, abuzimi ose neglizhence, nr. 18-6570/1, datë 6.07.2020.

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi **ditën e ardhëshme pas miratimit të tij**.

18-10074/2

17.7.2025, Shkup

Ministrja e Arsimit dhe Shkencës
Prof. dr. Vesna Janevska, d.v.

Tabela me shpërndarje të roleve dhe përgjegjësi

Kategoria e personave	Detyrat kryesore	Mënyra e veprimit	Vërejtje
Drejtori	Miratimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të aktit të brendshëm	Ndjek zbatimin, merr vendime në situata të ndërlikuara	Përgjegjës për organizimin e përgjithshëm
Bashkëpunëtorët profesionalë	Person kontakti për raportime, vëzhgim dhe marrje masash	Mbajnë procesverbal, punojnë me nxënësit, informojnë prindërit	Një person emërohet si kontakti zyrtar
Drejtuesit e klasës / mësuesit	Informimi i nxënësve, ndjekja e dinamikës në klasë	Paraqesin aktin e brendshëm dhe rregulloren në orën e klasës	Duhet të mbajnë evidencë për orët e zhvilluara
Personeli administrativ-technik (pastrues, personel teknik, sekretarë dhe të tjerë)	Vëzhgimi i sjelljes së nxënësve në oborr, korridore dhe hapësira të përbashkëta	Kur vëzhgojnë sjellje të dyshimtë, informojnë menjëherë stafin profesional	Duhet të jenë të njohur me indikatorët bazë të dhunës
Rojet ose sigurimi i jashtëm	Njohja e situatave me rrezik, parandalimi i veprimeve të dhunshme	Të jenë të gatshëm të reagojnë dhe raportojnë incidentet te personi përgjegjës në shkollë	Duhet të kenë trajnime bazë për komunikim me nxënësit
Nxënësit	Respektimi i rregullave dhe raportimi i dhunës	Në rast dyshimi ose dëshmie, i drejtohen mësuesit ose bashkëpunëtorit	Trajnuar në orët e klasës mbi bashkësinë e klasës
Prindërit / kujdestarët	Bashkëpunimi me shkollën, informimi për ndryshimet tek fëmijët	Reagojnë nëse fëmija tregon përvojë të dhunës	Të përfshihen në aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit

Tabela për kategorizimin e dhunës¹

Tabela 1-Niveli i parë				
Dhunë fizike	Dhunë emocionale/psikologjike	Dhunë sociale	Dhunë seksuale/abuzim	Cyber-dhunë
goditje me grusht, shtyrje, shtrëngim, gërvishje, tërheqje, kafshim, pengim, shkelje, përplasje, shkatërrim i sendeve	tallje, nënçmim, fjalë të liga, ofendime, përdorim emrash fyese, sharje, imitim, thirrje për turp	hedhje fjalësh, tallje, injorim	hedhje fjalësh, sharje, komente negative, gjeste me aluzion seksual	thirrje shqetësuese në telefon, SMS/MMS, mesazhe shqetësuese në rrjete sociale

Tabela 2- Niveli i dytë				
Dhunë fizike	Dhunë emocionale/psikologjike	Dhunë sociale	Dhunë seksuale/abuzim	Cyber-dhunë
shkelma, goditje, shkelje, shqyerje e rrobave, mbyllje, pështymë, marrje/shkatërrim pasurie	shantazh, kërcënime, dënim i padrejtë, etiketime, ndalim komunikimi, përjashtim, refuzim, manipulim	intriga, injorim, refuzim, mos-përfshirje, mos-pranim, manipulim, shfrytëzim, përjashtim diskriminues, fyerje/ndërrhyrje diskriminuese	prekje seksuale, shfaqje e materialit pornografik, ekspozim i pjesëve intime të trupit, zhveshje	reklama, video, blogje, abuzim në forume dhe chat, dhunë seksuale në lojëra, regjistrim skenash të dhunshme, shpërndarje pamjesh/snimkish private pa leje

Tabela 3 - Niveli i tretë				
Dhunë fizike	Dhunë emocionale/psikologjike	Dhunë sociale	Dhunë seksuale/abuzim	Cyber-dhunë
rrahje, mbytje, hedhje me pasojë të rënda fizike, sulm me shkop, thikë, armë ose objekt tjetër, djegie,	frikësim me shantazh, rrëmbim, kufizim lëvizjeje, përdorim i substancave psikoaktive, përfshirje në sekte, neglizhencë	kërcënime serioze për jetën, ngacmim nga grupi ndaj individit/grupit, diskriminim, organizim	manipulim nga të rriturit, nxitje, shantazh dhe detyrim për aktivitet seksual, përdhunim, sulm seksual ndaj	shpërndarje pamjesh/snimkish private pa leje, regjistrim i skenave vulgare/dhunshme dhe shpërndarje masive, shfaqje dhe

¹ Shënim: Në rastet kur vërehet se veprimi përbën keqpërdorim (përfshirë keqpërdorimin seksual, shfrytëzimin dhe manipulimin) ose neglizhencë (neglizhimi i nevojave bazë të nxënësit), shkolla e trajton këtë si një rrezik të lartë dhe vepron sipas masave për mbrojtje nga format e dhunës me rrezik të lartë.

Tabela 3 - Niveli i tretë				
Dhunë fizike	Dhunë emocionale/psikologjike	Dhunë sociale	Dhunë seksuale/abuzim	Cyber-dhunë
uria, ekspozim ndaj temperaturave të ulëta		grupesh të mbyllura (klan), fyerje/ndërhyrje diskriminuese	fëmijës nën 14 vjeç, ekspozim i organëve seksualë, marrëdhënie me abuzim pozicioni	prodhim i materialit pornografik

Shtojcë nr.2

Formular për Evidentimin e dhunës

1. Data dhe ora kur ka ndodhur ngjarja/situata e dhunshm _____

2. Lloji i dhunës / dëmtimi i nxënësit (shëno):

- ²☐ Dhunë fizike
☐ Dhunë emocionale / psikologjike
☐ Dhunë sociale
☐ Dhunë seksuale / abuzim
☐ Dhunë kibernetike
☐ Neglizhencë
☐ Tjetër: _____

3. Dhuna ndodh:

- ☐ Për herë të parë
☐ Përsëritet disa herë: _____ (shkruani sa herë)

4. Ku ka ndodhur dhuna (janë të mundshme më shumë përgjigje):

- ☐ Në klasë
☐ Në sallën e sportit
☐ Në korridore
☐ Në tualet
☐ Në oborrin e shkollës
☐ Në rrugë për / nga shkolla
☐ Në shtëpi
☐ Në internet
☐ Tjetër: _____

² Në rastet e dyshimit për keqpërdorim ose neglizhencë, shkolla është e detyruar të veprojë sipas nenëve 11 dhe 16 të rregullores, në koordinim me shërbimet profesionale dhe institucionet përkatëse.

5. Mënyra e zbulimit ose vërejtjes së dhunës(situatë të dhunshme:

- ☐ Mësimdhënës
- ☐ Nxënës dëshmitar ose nxënës që ka marrë vesh në mënyrë tjetër
- ☐ Bashkëpunëtor profesional
- ☐ Person kontakti për raportimin e dhunës ose zëvendësi i tij
- ☐ Raportim nga sigurimi
- ☐ Drejtori i shkollës
- ☐ Punonjës tjetër i shkollës
- ☐ Raportim nga prindi / kujdestari
- ☐ Raportim nga personi që ka përjetuar dhunën
- ☐ Raport anonim përmes e-mail, faqe interneti ose kuti
- ☐ Tjetër: _____

6.Përshkrim i ngjarjes

7. Pjesëmarrës në dhunë:

Plotëso me numër

7.1. Sa viktima ka në rastin konkret? ____

7.2. Sa autorë ka në këtë rast? ____

7.3. Nxënësi/ nxënësit viktimë të dhunës (ky seksion 7.3 kopjohet aty herë sa ka viktima në rastin konkret dhe plotësohet veçmas për secilën viktimë):

Emri dhe mbiemri: _____

Mosha: _____

Gjinia: _____

Përkatësia etnike:

☐ Maqedonase

☐ Shqiptare

☐ Turke

☐ Rome

☐ Boshnjake

☐ Vllehe

☐ Serbe

☐ Tjetër: _____

A është nxënësi fëmijë me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta arsimore?

Retho:

PO

JO

Pyetësin e realizoi:

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi:

Data:
